

**MBROJENI PUNËN TUAJ**



**Agjencia e mbikëqyrjes së sigurimit**

Rr. "Vasil Glavinov" Nr. 12

TCC PLAZA, kat i 2-të

1000 Shkup, Maqedoni

Tel: 02 3254 050

Faks: 02 3290 240

e-mail: contact@aso.mk

[www.aso.mk](http://www.aso.mk)

Orari i punës nga ora 08:30 deri 16:30

**Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural**

Rr. "Treta Makedonska Brigada" nr. 20,  
ndërtesa, Maqedonia Tabak, bloku C

1000 Shkup, Maqedoni

Tel: 02 3097 450; Faks: 02 3097 454

e-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk

[www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk)

Orari i punës nga ora 08:30 deri 16:30



AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

**SIGURIMI  
NË  
BUJQËSI**



Prodhuesit e produkteve bujqësore vazhdimisht janë ballafaquar me një seri rreziqesh që drejtpërdrejt ndikojnë në rendimentet (të ardhurat) bujqësore. Shumica e këtyre rreziqeve janë te lidhura ngushtë me kushtet e motit, fatkeqësitë natyrore, dëmtuesëve dhe sëmundjeve.

Kushtet e motit janë faktor të rëndësishëm për prodhimin e kulturave bujqësore, të cilat, për fat të keq, nuk mund të kontrollohen dhe përfaqësojnë një burim kryesor i pasigurisë për bujqit. Thatësira dhe rreshjet e tepërtë rezultojnë të vjelura të varfra. Për fat të keq, paqëndrueshmëria e temperaturës dhe reshjeve, si dhe shfaqjes së kushteve ekstreme të motit janë rritur në dekadën e fundit, dhe, ndoshta, kjo paqëndrueshmëri do të vazhdojë si rezultat i ndyshimit të klimës globale.

Për kuptimin e burimit dhe natyrën e rezikut është e nevojshme zhvillimi i strategjive për menaxhimin e rreziqeve. **Një mënyrë për të menaxhuar rreziqet është sigurimi i produkteve bujqësore të cilat do të mundësojnë kompenzim dhe mbrotjen e të vjelurave.** Kjo do të mundësojë bujqve për të zbutur ndikimet e rreziqeve që nuk mund të parandalohen.

## Qëllimi i Broshurës

Sigurimi si një investim individual në arritjen e cilësisë më të mirë dhe sigurimin e një rendimenti më të mirë të prodhimit, është e një rëndësie të madhe për zhvillimin e bujqësisë dhe përmirësimin i mirëgenies së bujqve. Në këtë mënyrë biznesi i bujqve do të jetë i mbrojtur nga moti dhe fatkeqësitë natyrore.

Kjo Broshurë ka për detyrë për të shpjeguar **pse bujxit duhet të sigurohen, gjegjësishtë pse të blejnë policë sigurimi për të mbrojtur pronën dhe vlerat tjera.**

Broshura do të mundësojë që bujxit të marrin përgjigje në pyetjet:

- ✓ Pset'i sigurojë prodhimet bujqësore?
- ✓ Si dhe ku mundë ta transferojë rezikun dhe kush mundë të shesë policë sigurimi?
- ✓ Çka paraqet polica e sigurimit?
- ✓ Cili është objekti i sigurimit?
- ✓ Cilat rreziqe janë të mbuluara nga sigurimi i të mbjelluarve dhe frutave?
- ✓ Cilat janë detyrimet e siguruesit?
- ✓ Cilat janë detyrimet e bujkut nga polica e nënshkruar?
- ✓ Cila është procedura mbi raportin e dëmit?
- ✓ Të drejtat e mia si dhe interesat si i siguruar ( përdorues sigurimi ) janë të mbrojtura në mënyrë adekuate?
- ✓ Cilat janë institucionet dhe përgjegjësitë e tyre?

## Pse të sigurohem?

Qëllimi i sigurimit nuk është për tu shmangur apo eliminuar rezikun, por i njeti të përcjellët në shoqërinë e sigurimit. Sa më i madh të jetë numri i të siguruarëve të cilat janë eksponuar në rreziqe të ngashme po aq më precise shoqëria e sigurimit mundet t'i vlersojë dëmet e pritëshme dhe rrjedhimisht, për të llogaritur prim adekuat dhe të favorshme për të siguruarit **e cila paraqet çmimin e sigurimit.**

Për të kuptuar kuptimin e sigurimit si dhe dhe funksionimin e tij, **së pari e nevojshme është të kuptojmë se çfarë është reziku?**

Reziku është një mundësi ose pasiguria e humbjes. Mundësia që kulturat bujqësore të dëmtohen ose të shkatërrohen tërsiht, rrjedhimisht, të humabasin të ardhura nga shitja e tyre paraqet një pasiguri e humbjes.

Ka disa metoda për menaxhimin e rreziqeve që mundë të shkaktojnë humbjen:

### 1. **Rreziku mund të shmanget!**

Është pothuajse e pamundur për të shmangur të gjitha rreziqet, sidomos kur është fjala për kulturat e të cilëve prodhimi është prekur drejtpërdrejt nga kushtet e motit.

### 2. **Rreziku mund të reduktohet!**

Nëse kulturat dhe frutat rriten në oranzheri, bujxit do të reduktojnë rezikun në mirëmbajtje të plote të oranzherive. Por reduktimi i rezikut nuk do të thotë largimi i saj e plotë.

### 3. **Rreziku mund të mbahet!**

Bujxit mundet plotësishëtë ose pjesërisht për të mbajtur një pjesë të rreziqeve, me qëllim apo pa qëllim. Megjithatë, kjo procedurë mundë te rezultojë në pasoja financiare për bujxit nëse do të ndodhin disa nga rreziqet.

### 4. **Rreziku mund të transferohet!**

Një mënyrë e transferimit të rezikut është sigurimi. Sigurimi ka rol vital në jetën shoqërore dhe private. Kjo zvoglon zvoglimin e pasigurisë lidhur me ngjarjet e pasigurta që mundë të ndodhin në të ardhmen dhe do të shkaktojnë rreziqe të panumërtë ekonomike. Me blerjen e polices së sigurimit, bujxit, rezikun do të kalojnë në shoqërinë e sigurimit.

## Kush mund të shesë policë sigurimi?

### - Shoqërítë e sigurimit

Me qëllim që të mbrojnë të ardhurat nga prodhimi dhe shitja e kulturave bujqësore nga rreziqet që janë më së shumti për shkak të kushteve të ndryshme atmosferike, bujqit mundet që rreziqet t'i transferojnë në shoqërítë e sigurimit të Jo-jetës me blerjen e policës së sigurimit për kulturat bujqësore. Veprimtaria e shoqërive të sigurimit në Republikën e Maqedonisë është rregullaur me Ligjin për mbikëqyrjen e sigurimeve, organ kompetent për mbikëqyrjen e shoqërive është Agjencia e mbikëqyrjes së sigurimeve.

Përveç shoqërive të sigurimit, në seli apo në ekspozituart e tyre, polica e sigurimit gjithashtu mund të shitet edhe nëpërmjet:

### - Shoqëria brokere të sigurimit

Shoqëria brokere e sigurimit është person juridik e cila ka leje nga AMS për shitjen e policave të sigurimit në emër dhe llogari të më shumë shoqërive të sigurimit.

### - Shoqëria agjentësh sigurimi

Shoqëria agjentësh sigurimi është person juridik e cila ka leje nga AMS për shitjen e policave të sigurimit në emër dhe llogari të një shoqërie sigurimi.

## Çka paraqet polica e sigurimit?

Me qëllim që të sigurohet mbulesa e sigurimit si mburojë nga rreziqet per kulturat bujqësore, e nevojshme është të nënshkruhet polica e sigurimit në mes te **bujkut/ tē siguruarit) dhe shoqërisë së sigurimit (siguruesit**). Polica e sigurimit konsiderohet e kontraktuar kur është e nënshkruar nga ana e tē siguruarit (kontraktuesit të sigurimit) dhe siguruesit dhe paraqet akt juridik me tē cilën shoqëria e sigurimit pajtohet për të bër pagesë në raste eventuale të humbjeve të bujqve si rezultat të reziqeve të siguruarra. Si zëvendësim të kësaj, bujqët, shoqërive të sigurimit duhet tu paguajnë primin e sigurimit e cila paraqet edhe çmimin e mbulesës së sigurimit.

Tipari më i rëndësishëm i policës së sigurimit është parimi i kompesimit. Ky princip sugjeron që kur ka një humbje, bujkut duhet t'i kompensohen aq mjete financiare, përafersishtë ashtu siç ishte gjendja para humbjes.

Me kontraktimin e sigurimit, **shoqëria e sigurimit ka detyrim që të sigurarit t'i dorëzojë kushtet e sigurimit**, tē cilat rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e siguruesit dhe tē siguruarit. Kushtet e sigurimit jepin përgjigje në pyetje si më poshtë:

- Cili është subjekti i sigurimit të prodhimit bujqësor?
- Periudha që i referohet sigurimit?
- Cilët rreziqe janë të mbuluara nga sigurimi?
- Cilët janë detyrimet e siguruesit për kompenzimin e dëmit?
- Cilët janë obligimet e tē siguruarit para dhe pas ndodhjes së ngjarjes së sigurimit?
- Cilët rreziqe përjashtohen nga sigurimi?

**Kohëzgjatja e policës së sigurimit**-Polica e sigurimit kontraktohet me kohëzgjatje të përcaktuar;

Në periudhë prej një viti ose me pak ( sigurim afat-shkurtër),  
Në periudhe më gjatë se një viti ose më shumë ( sigurim afat-gjatë).

## Çka është subjekti i sigurimit në bujqësi?

Çfarë do të jetë lëndë e sigurimit nvaret, parasëgjithash, nga aktivitetet e kryera nga bujku me rritjen e kulturave bujqësore. Bujqët, duke pasur parasyshë rreziqet të cilat paraqesin kërcënim për prodhimin e tyre, mundet me marëveshje me siguruesit të zgjedhin se cilat kultura, në çmasë dhe në cilën periudhë kohore të janë të siguruara.

### Shembuj:

- Nëse bujku kultivon kërp-trung për prodhimin e farës, mundet tē sigurojë vetëm farën. Por, në qoftë se në veçanti me marëveshje, sigurimi mundë tē mbulojë edhe trungan.
- Nëse bujku prodhon duhan, mundë tē janë tē sigurar gjethet e duhanit nga dita e tē mbjellurit të duhanit deri në mbarim të vjeljes, a më së voni deri në grumbullimin e duhanit. Por, në qoftë se prodhon farë atëhere në veçanti mundet tē ketë sigurim përfarën.
- Bujku që kultivon pemishte dhe vreshtë në rritje, te pemët mund tē sigurojë trungan ndërsa te vreshëti kërcën.

**Vërejtje:** Në KUSHTET e sigurimit mundë tē jetë e cituar se mbështetësit, gjegjësishtë armatura (shtyllat e betonit dhe tē drurit, teli dhe etj.) nuk janë tē mbuluara nga sigurimi.

## Cilët rreziqe janë tē mbuluara me sigurimin e prodhimeve bujqësore?

Cilët rreziqe do tē mbulohen me policën e sigurimit **nvaret, kryesishtë nga nevojat e bujkut**. Në marëveshje me siguruesin mund tē kontraktoni mbulesën e sigurimit që është më e përshtacme për bujken:

- Siguruesi do të jetë i detyruar të paguaj kompenzim nga sigurimi për dëmet e shkaktuara nga shkatërimi i kulturave bujqësore të siguruara , në kushtet kurë kulturat janë të pa vjeluara, nga një ose kombinimi i rreziqeve si: breshëri, ngrica, zjarr, rrule, stuhi, vërvshime, bora, etj.
- Siguruesi do të jetë i detyruar të paguaj kompezm nga sigurimi nga dëmet e shkaktuara si humbje e kualitetit te kulturave bujqësore për prodhimin e farës, pemëve nga një ose kombinimi i rreziqeve si: bresheri, ngrica, zjarr, rrule, stuhi, vërvshime, bora, etj.
- Siguruesi do të jetë i detyruar të paguaj kompezm nga sigurimi nga dëmet e shkaktuara ku janë të përfshira sigurimi i duhanit nga një ose kombinimi i rreziqeve si: bresheri, ngrica, zjarr, rrule, stuhi, vërvshime, bora, etj.

**Vërejtje:** Në KUSHTET e sigurimit qartë janë të shkruara se cilët rreziqe janë të përjashtuara nga sigurimi.

#### Cilët janë detyrimet e siguruesit?

Përveç detyrimeve të tjera sipas ligjit dhe KUSHTEVE, siguruesi i ka detyrimet e mëposhtme:

Detyrimi i siguruesit për të paguar kompenzimin e dëmit, nëse nuk shprehet ndryshe, fillon pas 24 orëve nga dita kur është shënuar fillimi i sigurimit në policën e sigurimit.

**Vërejtje:** Siguruesi nuk është i obliguar të paguaj kompenzimin e dakorduar nëse dëmi është shkaktuar me dashje apo me mashtrim nga i siguruari.

Siguruesi është i detyruar që me shkresë të informojë të siguruarin për emrin, statusin ligjor, vendin dhe adresën e shoqërisë së sigurimit, filjalën përmes të cilit është lidhur kontrata e sigurimit, si dhe për shoqërinë e agjentëve të sigurimit ose shoqëritë brokere të sigurimit, në rastet kur kontrata e sigurimit është lidhur nëpërmjet shoqërive të agjentëve të sigurimit ose nëpërmjet shoqërive brokere të sigurimit.

Siguruesi është i detyruar me shkresë të njoftojë të siguruarin për të drejtën e pezullimit ose ndërprerjes së kontratës së sigurimit.

Në rast se ka kontekst, siguruesi është i detyruar të njoftojë të siguruarin për mundësinë e zgjidhjes së kontekstit me proces jo-gjyqësor.

#### Kush janë detyrimet e bujkut nga kontraktimi i policës së sigurimit?

I siguruari është i detyruar të paguaj primin e sigurimit. Primi paguhet brenda afateve të miratuara, dhe nëse është e nevojshme të paguhet një herë, e njëjtë paguhet me kontraktimin e policës së sigurimit.

Bujku është i obliguar t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ndodhjen e ngjarjes së siguruar.

**Vërejtje:** Nëse ngjarja e siguruar ndodh, bujku është i detyruar për të marrë gjithëçka në fuqinë e tij për të kufizuar pasojat e dëmshme.

Në rast se ndodh dëmi, i njëjtë **duhet të raportohet në shoqërinë e sigurimit**. Mënyra e raportimit të dëmit është përshkruar në detaje në KUSHTET e marra nga siguruesi.

**Vërejtje:** Është konsideruar se dëmi ka ndodhur në atë moment, kur një nga rreziqet e sigurara fillojnë të shkaktojnë dëme kulturave bujqësore të siguruar.

#### Cila është procedura për raportimin e dëmit?

Pasi bujku duhet të dorëzojë kërkesë për zhdëmtim, siguruesi është i detyruar për identifikim dhe vlersim e dëmit. Identifikimi dhe vlersimi i dëmit bëhet nga përfaqësuesi i siguruesit ( vlerësues-ekspert bujqësor) dhe përfaqësues nga i siguruari.

Me kërkesë të siguruesit, bujku është i detyruar të paraqesë dokumentacionin në pajtim me dokumentacionin e nevojshëm, që dëmi të jetë përpunuar dhe i zgjidhur.

## **Çka pritej, gjatë dhe pas vlersimit të dëmit?**

Vlersuesi-eksperti bujqësor, shkon në teren ku kryhet vlersimi i drejtpërdrejt i kulturave bujqësore të dëmtuara për të përcaktuar shumën e kompenzimit konform policës së sigurimit.

Pas përcaktimit të shumës së kompenzimit nga ana e vlersuesit, siguruesi sjell vendim përfundimtarë për shumën e cila do t'i paguhet të siguruarit (bujkut). Siguruesi e njofton bujkun se vendimi ka detyrim ligjor që në afat prej 14 ditëve të kompezojë dëmin.

Në qoftë se bujku nuk është dakord me shumën e caktuar si kompenzim të dëmit, ka mundësi që të dërgoi ankesë deri te i siguruari për të cilën paraqetë argumente shtesë për arsyen pse nuk dakordohet.

Nëse siguruesi e refuzon ankesën pa shpjegim adekuat, bujxit të drejtat e tyre mundët i kërkojnë para gjykatës kompetente.

### **A janë të drejtat dhe interesat e mia si i siguruar (shfrytëzues sigurimi) të mbrojtura në mënyrë adekuate**

Në rast se i siguruari apo shfrytëzuesi i sigurimit mendon se shoqëria (siguruesi) nuk është në përputhje me dispozitat e policës së sigurimit, ka të drejtë të paraqesë ankesë në:

#### **Shoqërinë e sigurimit**

#### **Organizatën përmbrrojtjen e konsumatorëve**

(Rr. „Vodnjasnka“, Faksi P 150, 1000 Shkup, tel/faks: 02 3179-592);

#### **Agjencia e mbikëqyrjes së sigurimeve - AMS**

(Rr. „Vasil Glavinov“ Nr.12, TCC PLAZA; tel. 3 254 050).

Gjithashtu, i siguruari ka të drejtë ankesë kundër veprimtarisë të shoqërive të agentëve të sigurimit dhe shoqërive brokere të sigurimit.

## **Si dhe kurë të paraqitet ankesë deri te AMS?**

I siguruari (bujku) ka të drejtë të paraqesë ankesë deri te AMS kundër veprimit të shoqërisë së sigurimit(sigurues), shoqërisë brokere të sigurimit, shoqërisë agjente të sigurimit ose agjentit të sigurimit.

Për derisa në emër të bujkut, person tjetër e dorëzon ankesën , në bashkangjitje duhet të dorëzojë autorizimin e vërtetuar te noteri.

Bujku ka të drejtë që ankesën ta dorëzojë në AMS nëse paraprakishtë me shkresë është drejtuar deri te siguruesi dhe nuk është i kënaqur me përgjigjen, ose siguruesi nuk ka marë vendim për ankesën në afat prej 30 ditëve në dërgesen e të së njejtës. Ankesa dorëzohet deri në AMS me shkresë ose në formë elektronike dhe duhet të përmbajë elementët si më poshtë:

- Emër, mbiemër, adresa, numër telefoni;
- Sqarim për arsyen e ankesës;
- Kundër kujt dorëzohet ankesa;
- Kopjen e policës së sigurimit;
- Kopjen e ankesës së paraqitur deri te siguruesi dhe përgjigjen nga siguruesi; dhe
- Dokumentacione tjera shtesë, nëse posedon.

**Vërejtje:** Të gjitha shërbimet nga ankesat, të ofruara nga AMS janë falas.

## **Cilat janë institucionet dhe kompetencat e tyre?**

**Agjencia e mbikëqyrjes së sigurimeve në Republikën e Maqedonisë (AMS)** është institucion i pavarur rregulator me kompetenca dhe përgjegjësi për të rregulluar funksionimin ligjor dhe efikas të tregut të sigurimit.

AMS punon për të forcuar dhe për të inkurajuar zhvillimin e tregut të sigurimeve në vend. Këtë detyrë e realizon duke lëshuar leje për kryerjen e veprimtarisë së sigurimit, duke bërë kontroll të rregullt të shoqërive të sigurimit, shoqërise brokere të sigurimit, shoqërise të agentëve të sigurimit dhe monitorimin e performancës së tyre për të siguruar që shoqëritë e sigurimit në çdo kohë kanë mjaftueshmërinë financiare për të mbuluar dëmet e raportuara nga të siguruarit. Me punën e vet AMS kontribon në mbrojtjen adekuate të të drejtave dhe interesave të policë mbajtësve dhe të shfrytëzusëve të produktive të sigurimit dhe shërbimeve.

**Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural (APFBZHR)** është themeluar për realizimin e sukseshëm të masave të politkës bujqësore dhe zhvillimit rural në Republikën e Maqedonisë. Përmes funksionimit mundëson menaxhimin efikas të mjeteve financiare nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë si dhe me mjetet nga Bashkimi Evropian të dedikura për zhvillimin rural.

**APFBZHR** e implementon Programin për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural nëpërmjet masave të cilat janë të përfshira në sektorët e bujqësisë dhe zhvillimin rural në Maqedoni.

Në kuadër të programit për përkrahje financiare të bujqësisë miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në nivel vjetor, si mbështetje shtesë për zhvillimin e bujqësisë nga shteti në mënyrë që të stimulojë sigurimin bujqësor, ndihma financiare ofrohet për të subvencionuar primet për sigurimet.

Ndihma për primet e sigurimet është një pjesë e kostos së sigurimit për sigurimin e pronës bujqësore për prodhimin primar nga fatkeqësítë natyrore dhe ngjarjet e papëlqyeshme klimatike.

Shuma e ndihmës nuk do të tejkalojë 60% të kostos së primit të sigurimit për kompensimin e dëmit në prodhimin primar ndodhur si rezultat i fatkeqësive natyrore, por jo më shumë se 200.000 denarë për fermë.

#### **Shfrytëzusit**

Shfrytëzuesit janë fermat që kanë përbushur kriterët e programit dhe kanë kapacitetet maksimale si më poshtë:

- a) fidane rushi dhe pemishte deri në 5 ha,
- b) kulturat kopshtare deri në 2ha,
- c) duhan deri në 1ha,
- d) drithëra deri në 10ha,
- e) familje bletësh deri në 100.

#### **Procedura për marrjen e mbështetjes financiare**

1. Kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve me dokumentacionin e kërkuar dorëzohet në zyrat rjonale të Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ujrale deri më datë 30.08.2012.
2. Njësia rjonale bazuar në të dhënat e Regjistrat të vetëm, bujku i jep Vërtetim për posedimin e kapaciteteve bujqësore dhe të njejtin ia dorëzon aplikantit.
3. Aplikanti, vërtetimin ja dorëzon shoqërisë së sigurimit.
4. Shoqëria e sigurimit lëshon Policën e sigurimit.
5. Një kopje të Policës, aplikanti e kthen në njësinë rjonale me çka e plotëson dosjen e vetë.
6. **APFBZHR** pas verifikimit të përputhshmërisë me kriterët e përcaktuara në program do të kryjë pagesën sipas faturës në llogari të shoqërisë së sigurimit, në përfitim të aplikantit dhe atë në vlerë prej 60% nga vlera e përgjithshme e Policës.
7. Aplikanti mbështetjen financiare për prodhimin bujqësor mund ta sigurojë në shoqërinë e sigurimit sipas zgjedhjes së tij.